



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900518/8

Tiranë ___/___/2019

Lënda : *Kërkesë për dhënien e masës disiplinore ndaj Kryeinspektorit të IMT të Bashkisë Tiranë Z. Maringlen Qato*

BASHKISË
Tiranë

Me shkresën nr. K2/Xh6-2 prot., datë 10.04.2019, i jemi drejtuar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë, duke e vënë në dijeni se Institucioni i Avokatit të Popullit ka iniciuar kryesisht shqyrtimin e çështjes së prishjeve për qëllime publike të ndërtimeve në zonën e ish-Stationit të Trenit - Bregu i Lumit, Tiranë, në kuadër të realizimit të projektit për zgjatimin e Bulevardit të Ri.

Referuar mediave të ndryshme për reagimin e banorëve të kësaj zone ndaj procedurave të nisura prej IMT të Bashkisë Tiranë, në datën 09.04.2019, përfaqësuesit e institucionit tonë kanë marrë takim me disa nga banorët që preken nga ky projekt. Përveç pretendimit të ngritur për mos dhënien e dëmshpërblimit për prishjen e banesave të tyre, shtetasi Xh.G. pretendoi se, ai dhe baxhanaku i tij, i quajtur B.Ll., për të kundërshtuar dhe mos lejuar prishjen e banesave të tyre dhe të kunatit të vet, të quajtur L.K., janë ngjitur në çatinë e banesës së këtij të fundit. Fadromisti (personi që drejtonte mjetin motorik të IMT-së) megjithëse e ka parë që ata të dy ishin mbi çatinë e banesës, filloi prishjen e çatisë. Pas ndërhyrjes së mjetit, është prishur një pjesë e çatisë dhe pas kësaj ankuesi Xh.G. ka rënë së bashku me materialet e çatisë duke iu rrezikuar seriozisht jeta. Pasi ka rënë nga lartësia rreth tre metra, fatmirësisht ai ka ngecur mbi trarët e saj duke ngelur i dëmtuar në pjesën e shpinës sipër legenit në pjesën e majtë. Pas kësaj ka qëndruar aty rreth 30 minuta sepse nuk lëvizte dot dhe pastaj ka mundur të dalë që aty dhe të zbresë poshtë me anë të shkallëve metalike. Pas zbritjes poshtë dhe për shkak se kishte dhimbje, ai është dërguar nga dy punonjës policie me një autoambulancë në Spitalin e Traumës Tiranë, ku i është nënshtruar disa ekzaminimeve mjekësore. Nga bërja e ekzaminimeve mjekësore ai ka rezultuar që të ketë shembje në pjesën e shpinës, sipër legenit, në anën e majtë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e këtij rasti me shkresat e cituara më sipër i kemi kërkuar Kryeinspektorit të IMT të Bashkisë Tiranë të na dërgonte shpjegime lidhur me:

1. Cili është qëndrimi juaj në lidhje me pretendimet e ankuesit të parashtruara më sipër?

2. Nëse këto pretendime qëndrojnë, cilat janë arsyet e kryerjes së këtij veprimi duke rrezikuar seriozisht jetën e ankuesit?

3. Cilat janë gjeneralitetet e drejtuesit të fadromës (mjetit motorik) të përdoruar nga IMT-ja e Bashkisë Tiranë në prishjen e banesës së shtetasit Lulzim Kovaçi?

IMT e Bashkisë Tiranë me shkresën nr.16000/1 prot., datë 16.05.2019, na informoi se, ky organ ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtime të kundërligjshme”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 894, datë 04.11.2005 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”.

Në përfundim të shkresës na informoi se, nuk është në dijeni të pretendimeve të ngritura nga qytetarët e cituar në shkresën tonë.

Nga përgjigjia e cituar më sipër konstatojmë se:

Së pari, përveç faktit që kjo përgjigje është dërguar tej afatit ligjor, ajo nuk është korrekte, sepse nuk është dërguar informacioni i kërkuar nga ana jonë sikurse është parashtruar në kërkesën për shpjegime të cituar më sipër.

Së dyti, nëse Kryeinspektori nuk kishte dijeni për këtë rast, ka detyrimin kushtetues e ligjor, i cili rrjedh nga dispozitat e akteve normative në fuqi, që ta verifikonte atë dhe të na dërgonte informacionin e kërkuar.

Së treti, vonesa në kthimin apo moskthimi e përgjigjes së kërkuar Institucionit të Avokatit të Popullit ka sjellë si pasojë mos korrektesën e institucionit tonë për trajtimin në afat të ankesës në fjalë.

Së katërti, ndodhur përballë këtij fakti, me shkresën nr. K2/Xh6-5 prot., datë 18.06.2019, i bëmë me dije z. Qato përmbajtjen e nenit 22/1 (Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit) të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, i cili parashikon se:

“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”

Pas kësaj shkrese, IMT e Bashkisë Tiranë me shkresën nr.16000/3 prot., datë 02.07.2019 na dërgoi shpjegime dhe disa fotokopje të dokumentave të ndryshme, por përsëri nuk na dërgoi informacionin e kërkuar me shkresat tona dhe për tre pyetjet e parashtruara më sipër.

Sjellim në vëmendje se, mos kthimi i informacionit të kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit është rast tipik i mos bashkëpunimit të një organi të administratës publike, IMT i Bashkisë Tiranë, me Avokatin e Popullit.

Ky qëndrim çënon rëndë imazhin dhe besimin publik të këtij organi dhe të Bashkisë Tiranë. Njëkohësisht ai pengon kryerjen e misionit kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese e ligjore të shtetasve nga organet e administratës publike.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në nenin 22/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të cilin e kemi cituar më lart,

K Ë R K O J M Ë :

1. Të analizoni këtë qëndrim të kundërligjshëm të Kryeinspektorit të IMT të Bashkisë Tiranë z. Mariglen Qato për mos bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit.

2. Të filloni procedurën administrative dhe të merrni masë disiplinore ndaj tij.

3. Të merrni masat e nevojshme për dërgimin nga IMT e Bashkisë Tiranë të informacionit të kërkuar nga Institucioni i Avokati i Popullit lidhur me rastin e përshkruar më sipër dhe mos përsëritjen e këtyre shkeljeve ligjore në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të kësaj kërkesë, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi